

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 345, Datë 29.12.2025

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “VOLTON” SH.P.K. PËR ZGJIDHJEN E
MOSMARRËVESHJES ME SHOQËRINË OSSH SH.A., LIDHUR ME PIKËN E
MATJES “TONA ALB/6390”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20 gërmat “a” dhe “ë”, nenit 24, pikat 1, 2, 3 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 15 dhe 23 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 03.09.2016; nenit 11 të Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.12.2025, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve me nr. 2489/5 prot., datë 24.12.2025, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Volton” sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqëritë ‘OSSH’ sh.a., lidhur me pikën e matjes “Tona Alb/6390”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “VOLTON” sh.p.k., me shkresën e datës 19.09.2025, të protokolluar pranë Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me nr. 2489 prot., datë 19.09.2025, ka paraqitur kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së lindur me shoqërinë OSSH sh.a., lidhur me konfigurimin e gabuar të parametrave të matjes së energjisë elektrike në pikën e matjes “TONA ALB/6390”, si dhe me efektet financiare të pretenduara nga ky gabim.
- Sipas parashtresave të “VOLTON” sh.p.k., konfigurimi i pasaktë i transformatorëve të rrymës ka sjellë matje të fryra të konsumit të energjisë elektrike për periudhën 20.02.2025-30.03.2025, duke ndikuar në planifikimin dhe blerjen e energjisë elektrike në tregun “day ahead” dhe duke krijuar, sipas shoqërisë, një dëm ekonomik të konsiderueshëm.
- Shoqëria OSSH sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 10701/1 prot., datë 15.10.2025, të protokolluar në ERE me nr. 2489/2 prot., datë 17.10.2025, ka bërë me dije se: gabimi në konfigurimin e parametrave të matjes ka qenë i natyrës njerëzore, është konstatuar dhe korrigjuar, janë kryer rillogaritjet përkatëse dhe se matjet finale janë vënë në dispozicion të furnizuesit brenda afateve të parashikuara, duke vlerësuar se detyrimet e operatorit të shpërndarjes janë përmbushur.

- Nga dokumentacioni i administruar rezulton se palët mbajnë qëndrime të ndryshme lidhur me pasojat financiare të gabimit të konstatuar në matje dhe me ekzistencën ose jo të një detyrimi për kompensim ekonomik. Në kuadër të shqyrtimit të kësaj kërkesë rezulton se:
- Shoqëria “VOLTON” sh.p.k. është e licencuar nga ERE për veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike me vendimin nr. 268, datë 10.12.2024, ndërsa shoqëria OSSH sh.a. është operator i licencuar i sistemit të shpërndarjes me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, i ndryshuar me vendimet nr. 216, datë 11.10.2018 dhe nr. 224, datë 09.11.2021.
- Në nenin 24 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, përcaktohet se ERE vepron si autoriteti kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura ndërmjet të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, në përputhje me rregulloren përkatëse.
- Në këto rrethana, vlerësohet se çështja e paraqitur përbën një mosmarrëveshje ndërmjet dy subjekteve të licencuara dhe se palët legjitimohen për t’iu drejtuar ERE-s për zgjidhjen e saj, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.
- Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve trajtohet nga ERE në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 08.07.2016.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “VOLTON” sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë OSSH sh.a., lidhur me pikën e matjes “TONA ALB/6390”, dhe fillimin e procedurës për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeje.
2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë “Volton” sh.p.k. dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSH) sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI